



Dalës-Izlazn:

Nr. 1-59
Br.

Data 20.05.2020
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilic - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI³⁵, mbledhja e 4) me dt.29.05.2020 (e premtë) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:


R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit 3 mujor financiar i DEFZH-së
4. Shqyrtimi i Raportit të DSHMS-së, menaxhimi i situatës me pandeminë (Covid 2019)
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Kryetarit të Komunës për vitin 2019
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri



Dalës-Izlozns

Nr. J-60

Data 20.05.2020

Br.

Datum

OBILIQ-OBILIC

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilic - Municipality Assembly Obilic

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.28.02.2020, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Burim Gërguri (AAK), Labinot Mirena (AAK), Florije Jashari (AAK), Muhamet Mustafa (AAK) Qendresa Dubova (AAK), Enver Gashi (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatmir Bekteshi (LDK), Fatos Kurshumlja, (LDK), Linda Sadiku (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Hysni Mjeku (PDK), Lulzim Sadiku (PDK), Samire Berisha (PDK), Aziz Bici (LVV), Xhezide Dragusha, (LVV), Nora Preniqi (LB), Armend Rushiti (LB), Nazmi Gashi (Nisma), Slavisa Spasic (SL) dhe Dragan Dancetovic (SL).

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiqi, Nënkryetar i Komunës, drejtorët komunal, Ganimete Aliu, zyrtare për barazi gjinore, përf.i IZHL-së

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Planit të punës së Kryetarit për vitin 2020
4. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së, për bartjen e mjeteve nga viti 2019-2020
5. Shqyrtimi i kërkesës së DKA-së
6. Shqyrtimi i Propozim Vendimeve të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë në Zonën industriale në Llazarevë
 - a) Investitori: NTP: "Medruplast"
 - b) Investitori : "Elite O.P"
 - c) Investitorit: "Baruti Group SH.P.K"
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Aprovohet me 17 vota për rendi i ditës i cekur më lartë.

Pika e 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika e 2 e rendit të ditës

Aprovohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

Pika e 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Ju njoftoj se Kryetari ndodhet në një udhëtim zyrtar në SHBA, por e kemi Nënkryetarin për çdo gjë që na nevojitet, e po ashtu edhe drejtorët komunal.

Aziz Bici – Plani i punës së Kryetarit për vitin 2020, nuk ngërthen në vete diçka të re, por është një përsëritje e planeve të viteve paraprake, të cilat nuk kanë sjellë diçka të mirë për qytetarët përveç problemeve dhe ngecjeve ekonomike, siç është projekti i sheshit të qytetit, që edhe pse një hapësirë shumë e vogël e këtij projekti me vite ka bllokuar jetën e qytetarëve dhe bizneseve. Sa i përket Ligjit për Obiliqin, tendenca e Kryetarit shihet se për ta përvetësuar këtë ligj si meritë personale, është pak qesharake sepse të gjithë qytetarët e dijnë se si është ardhë deri te ky ligj. Mirëpo, çështja nuk është këtu sepse te vlerësimi i Kryetarit se ky ligj është duke u implementuar në tërësi, gjë që nuk është e vërtetë sepse alokimi i taniemës nuk është tërësia e ligjit. Ende nuk është duke u implementuar projekti brezi i gjelbërt, tarifa më e favorshme e rrugës për banorët e zonës së rrezikuar, në rast mundësie për të cilën dhe me të cilën kemi fituar edhe votë bukur shumë, sidomos në zgjedhjet lokale. Te ndarja e buxhetit nuk shihet diçka e re që ti joshë të rinjtë dhe të rejtat, që të qëndrojnë dhe ta duan jetën në Obiliq. Në anën tjetër mjetet më të shumta do të shkojnë në infrastrukturë në përsëritjen e projekteve dhe shumë pak në fushat si Arsim, Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale. Te ndarja e buxhetit, duket një ndryshim dhe te pagat dhe meditet që është rritur për gjysëm milion dhe dua të na shpjegoj Kryetari, ose drejtori se si erdhi deri te kjo, a janë rritur pagat apo numri i punëtorëve. Për vitin 2019, për këtë kategori janë ndarë 4 milion e 78,259 €, ndërsa për këtë vit 4 milion e 621,061 €. Në këtë plan pune nuk shohë diçka të re te Drejtoria e Arsimit, që kemi paraparë ndërtime të ankeseve, renovime të ndryshme si dhe nuk shohë investime në kabinete dhe kushte përcjellëse që do ta ndihmonin dhe përmirësonin mësimnxënien.

Kryesuesi – Ju e dini se buxheti është aprovuar në shtator të vitit të kaluar dhe janë të parapara të gjitha kategoritë e investimeve. Ky është plani i punës së Kryetarit, që me qenë sa më transparentë ndaj qytetarëve dhe e di se fjalimi ishte politik, që e mirëkuptoj.

Lulzim Sadiku – Sa i përket planit të punës së Kryetarit, lirisht kjo pikë është dashur të quhet plani i punës së drejtorëve dhe Drejtorive komunale. Vërtetë, është një lojë e thjeshtë e planit të punës së drejtorëve dhe atë një përshkrim i punëve të Drejtorive, që e kanë në bazë të organigramit. Shembulli më i keq i kësaj është përshkrimi i punëve të Zyrtarëve të Personelit, që s'kanë lidhje me punën e Kryetarit. Po ashtu, është marrë copy paste edhe planifikimi i buxhetit, ku vetëm janë përshkruar të gjitha projektet e planifikuara me buxhet, të cilat në terren nuk i realizon Kryetari, por Drejtoritë përkatëse. Asnjë planifikim të Kryetarit nuk ka për ndonjë agjendë bashkëpunimi ndërkomunal me Komunitat fqinje. Po ashtu, sikur edhe përgjatë viteve të qeverisjes së këtij Kryetari, nuk ka asnjë plan që lidhet për ndonjë aktivitet apo me ndonjë bashkëpunim ose binjakëzim me ndonjë Komunë jashtë vendit tonë. Prandaj, unë e quaj plani i Drejtorive, e jo i Kryetarit.

Kryesuesi – Sinqerisht komenti ishte interesantë, Kryetari është i zoti i shtëpisë, ndërsa drejtorët janë të emëruar. Ky është një plan që ia vlen të respektohet sepse dikush nuk ka as plan qeverisës, as plan të punës, prandaj më mirë një plan i keq se sa të jemi fare pa plan.

Ibush Mjekiqi – Sa i përket buxhetit, ju e dini se është aprovuar në shtator të vitit të kaluar në këtë Kuvend. Pagat kanë qenë të përcaktuara në bazë të Ligjit të aprovuar në vitin e kaluar për shërbyesit civil, që ka pasë ndikim në rritjen e masës buxhetore në përgjithësi dhe siç e dini ky ligj është pezullue nga Gjykata kushtetuese deri në fund të marsit. Prandaj, jemi në pritje të vendimit të Gjykatës lidhur me këtë çështje. Ne jemi takuar me ministrin e ri të financave, i cili na njoftoi në detale se çka do të ndodhë me këtë masë të mjeteve në rast se ligji kthehet dhe duhet të zbatohet, atëherë ne duhet ta kemi atë masën e parë që e kemi planifikue për pagesën e shërbyesve civil. Ligji për Obiliqin, është e vërtetë se nuk është duke u zbatuar me të gjitha pikat dhe ne jemi në rrugëtim e sipër, por në të ardhmen shpresoj se ky ligj do të zbatohet në tërësi. Është e rëndësishme se taniema është duke u zbatuar dhe rrjedha e parasë edhe në vitin e kaluar, por edhe në këtë vit është pothuajse e njejta masë. Konsideroj se Obiliqi, ka pasë nevojë për një shesh të tillë, punimet janë duke u zhvilluar dhe dinamika e zhvillimeve është deri me dt.1 shtator të këtij viti. Sa i përket planit të punës së Kryetarit, varet si e quajnë anëtarët e Kuvendit, është me rëndësi se është një plan që parasheshë se çka çdo të punojnë Drejtoritë, apo sektoret e Komunitat tonë.

Aziz Bici – Fjalimi nuk ishte krejtë politik dhe përgjegjen rreth Ligjit për paga e mora, që është e arsyeshme. Mendoj se më mirë herave tjera, Komisioni i cili i vlerëson operatorët që ofertojnë ti përzgjedhin ata të cilët e kanë një dinamikë të arsyeshme të punës, se sa të kalojnë 2 vjet, për një punë aq të vogël. Unë më mirë kisha pritë prej juve Nënkyetar, që të bëni një autokritikë për juve sepse bizneset për qytetarët tonë janë pengesë.

Ibush Mjekiqi – Në emër të Ekzekutivit, vlerësoj se dinamika e punimeve është deri me dt.1 shtator 2020, sepse edhe ju vetë e dini se këtu kemi pasë dhe ende kemi probleme pronësore, sidomos në ndërtesën e vjetër ku janë banorët. Mendoj se, jo vetëm operatori që nuk është në dinamikë të punimeve, por edhe problemet pronësore e kanë pamundëuse kryerjen në afat sa më të shkurtë të këtij projekti.

Lulzim Sadiku – Më duket nganjëherë se njerëzit që japin vërejtje, ty të duket ndoshta gjithçka politike sepse nuk është politike kur thuhet se nuk është plan, por copy paste i buxhetit të aprovuar në shtator. Po ashtu, nuk është politike nëse, dikush e jepë një vërejtje se nuk është punë e Kryetarit përshkrimi i punës së zyrtarëve për vitin 2020. Plani i drejtorëve, është bërë copy paste dhe nuk di çka e lidhë me Kryetarin e Komunës, që jam bindës se këtë raport Kryetari nuk e ka parë sepse kështu nuk e kishte lejur. Në nëse, japim kritika për të mirë nuk po bëjmë politikë, por mendojmë se këtu duhet të gjendet një modul që të bëhet plani i Kryetarit, se çka në atë plan mund të hyj për vitin 2020.

Ibush Mjekiqi – Unë nuk kisha me thënë që është kritikë, por sugjerim dhe e marrë si sugjerim.

Kryesuesi – Unë kur thashë politikë, e thashë me një qëllim tjetër sepse ligji është aprovuar në vitin 2016, dhe tek në qeverinë e dytë ka fillue me u zbatue ligji për taniemë. Uroj, që tash pasi që je afër Kryeministrit me i shtye proceset përpara, me fillue edhe nenet tjera, të ligjit me i zbatue.

Aziz Bici – Unë asgjë më tepër nuk thashë se sa që është meritë e të gjithë qytetarëve, veçanërisht iniciativa për qendrën në Obiliq, ndërsa kur e merrë dhe e lexon sikur kjo meritë krejtë i takon Kryetarit. Unë edhe pa shkuar atje, jam në gatishmëri që sa më shpejtë të votohet Ligji për Obiliqin sepse është interesi jonë.

Pika e 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën e DEFZH-së, për bartjen e mjeteve nga viti 2019 në vitin 2020.

Zarife Behluli – Së pari e kemi rritjen e të hyrave vetanake 2019 në vlerën prej 48,174.24 €, dhe për këtë na duhet vendim i veçantë. Po ashtu, kemi edhe bartjen e mjeteve sipas kategorive ekonomike: Paga dhe Meditje 78,000.01 €, Mallra dhe Shërbime 121,806.79 €, Shpenzime Komonale, 44,365.56 €, Subvencione, 50,410.69 €, dhe Investime Kapitale 619,416.39 €. Totali për bartje është në vlerën prej 913,999.44 €.

Kryesuesi – Në mbledhjen e KPF-së, është ngritë çështja pse po bëhet kjo bartje e mjeteve, por shumica janë kontrata të lidhura në vitin 2019, që kanë afat deri në vitin 2020.

Lulzim Sadiku – Vërtetë, rashë pak në lajthitje, sepse nga 48,000 €, ndryshuan shifrat. Kontratat që kanë qenë të lidhura në vitin 2019 dhe që janë deri në vitin 2020, kishte me qenë mirë me i pa, që me na bind neve pse po bëhet ky ndryshim i madh sepse tash po flitet për një shumë 913,999.44 €. Mendoj se kishte me qenë shumë më transparente sikur ne të ishim bindë se kontratat të cilat nuk kanë përfundue në vitin 2019, tash jemi në vitin 2020, që edhe si njoftim për qytetarë dhe si anëtarë të Kuvendit, do të kishim votue pak më drejtë dhe pak më mirë. Unë shumën prej 48,000 €, e kuptova se duhet me shkue në planin dinamik

Kryesuesi – Jo, është rritje e të hyrave.

Lulzim Sadiku – Nëse, kalojnë në planin dinamik, dua të di se cili është plani dinamik, në të cilën pikë dhe ky është plani dinamik për të cilin po flasim. Dua, të di se shuma prej 913,999.44 €, bartet nga viti 2019 në vitin 2020, afërsisht 1 milion, që në fakt jam pak i zbehur me votue këtë ndryshim sepse nuk po bindem se duhet për 1 milion të merren këto vendime aq të shpejta, aq me nguti pa u njoftue anëtarët e Kuvendit.

Ibush Mjekiqi – Meqë, po thua pak i zbehur çka kishe bërë ti me këto mjete. Ne duhet të marrim vendim për rritjen e të hyrave vetanake, ndërsa sa i përket pjesës së dytë janë kontrata të lidhura dhe pjesa e finansimit të kontratave ka qenë prej 2 burimeve, prej grandit dhe të hyrave. Ne në vitin e kaluar nuk i kemi shpenzue të hyrat, por i kemi shpenzuar grandet dhe kanë mbetje mjete të hyra, që do të barten për këtë vit për finalizimin e kontratave që janë me afat 1 vjeçar.

Lulzim Sadiku – Ne duhet të jemi transparentë sepse po flasim për kontrata të lidhura në vitin 2019, por nuk po dijmë për çfarë kontrata dhe është shumë e madhe e mjeteve për të cilën po bisedojmë.

Ibush Mjekiqi – Sqaron se secila Drejtori ka mundësi të sjelljë në të ardhmen se sa është kontrata psh në një rrugë të caktuar sepse janë 5 kategori dhe nuk është vetëm kategoria e investimeve kapitale, por janë pagat dhe medijtjet, duke përfshirë edhe subvencionet, shpenzimet që do të thotë se të gjitha janë të specifikuar. Ne jemi shumë të hapur dhe ka mundësi edhe me ardhë me rishikue atë projekti te DEFZH-ja.

Kryesuesi – Sqaron se në faqen e 3, të materialit që e keni pranue janë shpenzimet komunale, që ndoshta kanë qenë 30,000 €, por 11,000 €, kanë mbetë për këtë vit sepse është kontrata e lidhur. Pra, janë në dokument të gjitha kontratat e lidhura, që mundeni me i kuptue të gjitha.

Zarife Behluli – Sqaron se unë jam prej vitit 2014, në Komunën e Obiliqit dhe ndoshta kurrë nuk e kam ditur se si shkon mbledhja e Kuvendit, si barten të hyrat dhe ku duhet të bëhet rritja e mjeteve. Nëse, brenda vitit bëhet tejkalmimi i të hyrave vetanake, ne jemi të obliguar ti paraqesim në Kuvend se ku doni ju ti dërgoni, apo propozon Kryetari se ku do ti bartë mjetet, ju e votoni. Rritja e të hyrave, që ka ndodhë në vitin 2019, ne i kemi dërguar te anekset shkollore në Obiliq.

Aziz Bici – Është për me u vlerësue shuma prej 48,000 €, e të hyrave, po flasim për pjesën tjetër që po kërkohet bartja e mjeteve dhe votimi, që s'besoj se do ta votojmë sepse dhënja e kriterëve pa kriterë të mirëfillta, e sjellin këtë gjendje. Sidoqoftë, besoj se këto mjete ekzistojnë dhe nuk barten vetëm në letër dhe këtu, është shqetësimi ynë. Tash, na mbetet neve, ose i mbetet auditorit me shqyrtue sepse dyshoj se planin dinamik nuk e kanë respektue ata sepse ne më heret pikërisht që folëm për planin dinamik dhe aty është shqetësimi ynë.

Kryesuesi – Sqaron se ky dokument është protokoluar, dhe atë material që e keni ju e ka sjellë edhe Drejtorja e financave. Gjithsesi, ju e dini se ne me plan të punës së Kuvendit në muajin e 7, e kemi shqyrtimin e raportit të zyrës kombëtare të auditimit për vitin 2019.

Nazmi Gashi – Sa i përket buxhetit, i kam thënë drejtoreshës se unë me një pension e kam problem, por jam shkue në 3 seminare të rregullta, ku edhe kam marrë njohuri të mira. Këtu, ishin 2 kanale të forta për mjetet që mund të vijnë në Komunë, që janë grandet dhe të hyrat vetanake. Grandet ti marrin nëse, ti zënë ndërsa të hyrat vetanake barten. Dua, ta pyes drejtoreshën se a kemi humbje në buxhet prej sistemeve gjygjësore për ndonjë kompensim, apo pronë.

Kryesuesi – Përgjegjet se të gjitha do ti keni në raport në muajin e ardhshëm.

Muhamet Mustafa – Dua, të shtroj një pyetje për raportin e të hyrave vetanake për vitin 2019, në kategorinë gjoba dhe denime janë 120,142 €, po supozoj se nëse, në këtë vit disiplinohen vozitësat a ndikon kjo në planifikimin e të hyrave vetanake për vitin 2020.

Ibush Mjekiqi – Përgjegjet se buxheti nuk është statik, por elastik sepse nëse lëviz një kategori, lëviz edhe tjetra dhe natyrisht që pak ndikon në buxhet, prandaj, ju jeni këtu për me korrigjue.

Kryesuesi – Sqaron për gjobat dhe denimet se deri në vitin 2009, nuk janë marrë kurrë sepse shumica e gjobave, që janë bërë kanë shkue në regjionin e Prishtinës. Në atë kohë është formuar një Komision nga Kuvendi komunal dhe e kanë shqyrtue çështjen bashkë me regjionin e Prishtinës, dhe në bazë të numrit të identifikimit i kanë ndarë sepse kemi gjoba trafiku dhe gjobat tjera. Këto, gjoba zakonisht në fund të vitit mbledhen dhe duhet të barten për vitin e ardhshëm.

Lulzim Sadiku – Mua, vërtetë kolegu më befasoi dhe dua, të di gjobat në shumën prej 111,000 €, konkretisht çka ka ndodhë sepse më duken shumë mjete.

Kryesuesi – Përgjegjet se në muajin e ardhshëm do ta merrni raportin nga Zyra e Kryetarit.

Zarife Behluli – Sqaron se shumica e të hyrave, nga gjoba janë denime në trafik.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 18 vota për e aprovuan Vendimin për Tejkalmimin e të Hyrave Vetanake të Planifikuara për vitin 2019.

Dhe

Anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 6 vota kundër e aprovuan Vendimin për Lejimin e mjeteve Buxhetore në vlerë prej 913,999.44 €, sipas kategorive.

Pika e 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën e DKA-së për pagesën e obligimeve sipas kontratës kolektive të dt.18.04.2017.

Agim Spahiu – Ju njoftoj se janë disa kategori, obligime sipas kontratave kolektive për të punësuarit aktual dhe për të punësuarit të cilët kanë dalë në pension. Komuna e Obiliqit është Komunë e para dhe e vetme që mësimdhënësit të cilët kanë dalë në pension, ju ka ofruar kompensimin e shpenzimeve dhe e ka realizue pa procese gjyqësore. Para vitit 2014, pensionistët e kanë realizuar këtë të drejtë enkas përmes proceseve gjyqësore. Disa prej tyre nuk kanë procese gjyqësore. Të njejtë që kanë udhëheqë proceset gjyqësore e kanë gëzue të drejtën, ndërsa disa prej tyre ju janë refuzuar kërkespaditë. Kjo konsiston për të gjithë mësimdhënësit e pensionuar pasluftë, edhe para vitit 2014. Tani, e kemi obligim sipas kontratës kolektive që të pensionuarit sipas viteve jubilarë 30, e disa ndoshta edhe më shumë kemi propozuar dhe është aprovuar buxheti për këtë kategori të shpenzimeve, që është obligim buxhetor për vitin 2020. Ne do të fillojmë me obligimet ndaj kategorisë që kanë mbi 40 vjet, përvojë pune, 30, 20 dhe 10 vite. Ne do ti realizojmë të gjitha me përfundimin e vitit. Orientimisht shuma e mjeteve për këto obligimeve është 70,000 €.

Hysni Mjeku – Edhe në mbledhjen e KPF-së, kam propozue dhe kërkue për të gjithë arsimtarët e pensionuar që janë më se 17 të pensionuar dhe nuk ju kanë kompensuar mjetet, këtu është një amulli jo kanë bërë ankesë, jo s'kanë bërë ankesë. Ne dijmë se kemi marrë vendim, që të gjithë arsimtarëve që nuk ju ka kompensuar kjo shumë të ju kompensohet, bile kemi qenë unanim të gjithë anëtarët e Kuvendit duke parë edhe vullnetin e Kryetarit. Kjo, çështje sikur është neglizhue dhe mbi të gjitha ne prapë sot jemi të thirrur të marrim ndonjë vendim tjetër, që besoj se nga të gjithë të pranishmit askush nuk është kundër dhënjes së këtyre mjeteve. Këtu, u tha se disa kanë bërë ankesë e disa jo dhe Gjykata disa ankesa i ka aprovue, e disa i ka refuzue. Ne e kemi një vendim të Kuvendit, se jemi pro ndarjes së këtyre mjeteve dhe nëse këtyre 17 të pensionuarve nuk iu ka kompensuar e këta bëjnë kërkesë në Komunë, unë jam për atë që të ju kompensojmë mjetet. Apeloj te të gjithë anëtarët e Kuvendit komunal, që këtyre 17 punëtorëve të Arsimit të ju bëhet një zgjidhje dhe ajo të jetë pozitive në favor të tyre. Unë bile e kam edhe një kërkesë se në mesin e këtyre 17-ve, është edhe një i 18-ti, i cili fatkeqësisht nuk është më në mesin tonë që edhe ai të mos përjashtohet nga kjo e drejtë sepse e ka një familje, një bashkëshorte që ka qenë pjesë e procesit. Besoj se nëse, këtë e rrumbullakësojmë, atëherë e kryejmë një obligim moral dhe kombëtar.

Ibush Mjekiqi – Sa i përket vullnetit për pagesën e këtyre obligimeve, besoj se e kemi të gjithë dhe për këtë kanë filluar procedurat për kryerjen e obligimeve ndaj këtyre personave. Mendoj se drejtori duhet ta ndjekë rrugën ligjore sepse një vendim negativ i marrë nga Gjykata, duhet të shikohet se ne a kemi të drejtë ti kompensojmë ata, ndaj të cilëve është marrë ai vendim. Sa i përket pagave jubilarë, jo vetëm Drejtoria e Arsimit, por edhe e shëndetësisë dhe administratës komunale, vitin e kaluar kanë bërë një paramasë të mjeteve, për pagesën e punëtorëve të tyre. Në takimin e mbajtur të Kryetarëve të Komunave, me dt.25.02.2020, ku prezentë ishte edhe ministri është shqyrtuar kjo çështje, por pa aprovimin e buxhetit ne nuk mund ti kryejmë këto kompensime.

Agim Spahiu – Mësimdhënësit në pension të cilët kanë aktgjykimin e Gjykatës kompetente, unë jam përpjekur me i shikue rrethanat në të cilat gjenden këta pa fajin e tyre, që edhe këta me realizue këtë të drejtë. Mundësia ligjore është me riinicue procesin prapë njejtë sepse vetëm Gjykatat kanë autoritet që aktgjykimin të cilin e kanë nxjerrë me anulue dhe me nxjerrë aktgjykim të ri. Një prej këtyre 17-vetëve, që është pensionuar në vitin 2018, është i vetmi që i ka udhëheqë proceset gjyqësore dhe ne e kemi thirrë, po këtë e ka manipuluar një avokat. Ndërsa të gjithë të tjerët nuk mund të them se i kanë manipuluar avokatët sepse ka qenë rrugë e vetme që e kanë pasë të mundshme me realizue kompensimin e shpërblimit edhe jubilar dhe të 3 pagave. Unë jam konsultuar me Zyren ligjore, me juristë se aktgjykimet e Gjykatave janë obligative dhe janë të detyrueshme me i respektue secili, me i zbatue dhe jo me nxjerrë vendim mbi këto.

Kryesuesi – Ne duhet të gjejmë një model që këtyre 17 mësimdhënësve, me ua ndihmue procesin, me hapë rrugë ligjore që me gëzue atë të drejtë.

Lulzim Sadiku – Ju përgëzoj për këtë punë që po e bëni për çështje të pagave jubilarë, por dua të di se a është paraparë shujta dhe udhëtimi, pasi që në kontratën kolektive është paraparë shujta dhe udhëtimi për nxënës.

Nazmi Gashi – Vullneti është i të gjithëve për me ju ndihmue dhe ne s'mund të nxjerrim vendim, por rekomandim nga Kuvendi që Drejtoria e Arsimit dhe sistemi administrativ i Komunës me përmbyllë këtë Çështje.

Ibush Mjekiqi – Përgjegjet se shujta dhe udhëtimi nuk janë të parapara dhe ky është problem në nivel të vendit. Kontrata kolektive është nënshkruar në kohë të ndryshme, pa bazë buxhetore. Mirëpo, sido që të jetë ne do të bëjmë një zgjidhje për këtë çështje.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 18 vota për e aprovuan Vendimin për pagesën e obligimeve sipas kontratës kolektive, të dt.18.04.2017, njof.01B, nr.prot.2056, Neni 35, par.8, lidhur me shpërblimin jubilar për të punësuarit aktual në arsimin shqip në Komunën e Obiliqit, të cilët deri më tani nuk e kanë realizuar këtë të drejtë si obligim i punëdhënësit sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të theksuar më lartë.

Pika e 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet Propozim vendimin e Kryetarit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, Investitori “Medruplast SH.P.K”.

Ibush Mjekiqi – Vetë ardhja e kërkesës së Kryetarit në Kuvend, për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, tregon se vlerësimi i Kryetarit nga një ekip gjatë prezentimit, ku një pjesë e madhe e anëtarëve të Kuvendit, kanë qenë prezentë ka marrë një vlerësim pozitiv. Prandaj, është e drejta e juaj ekskluzive që të vendosni për dhënien apo mosdhënien e kësaj prone.

Lulzim Sadiku – Dhënia e këtyre tokave për 99 vjet në shfrytëzim, nuk ka asnjë justifikim sepse asnjë nga ofertuesit që i ka favorizue Kryetari, nuk paraqesin investitorë. Po ashtu, nuk ka asnjë siguri se aty do të punësohen njerëzit e Komunës tonë. Është thënë për Ligjin e Obiliqit në pjesën e punësimit për KEK, se do të punësohen njerëz nga Komua jonë në kushte të barabarta dhe Kryetari nuk ka arritë ta punësoj asnjë qytetarë. Pra, si pasojë ende nuk është arritë të zbatohet neni që e rregullon punësimin e njerëzve të Komunës tonë. Mendoj se pa një analizë të duhur Kryetari don me ia dhënë në shfrytëzim pronën, që nuk është në rregull sepse shumë mirë do të ishte të pritët edhe një kohë dhe të joshet ndonjë investitor i madh të cilit do të ia shihnin hajrin banorët e Komunës së Obiliqit. Ne kemi dhënë parcela për shumë firma, por shumë pak punëtorë kemi të Komunës së Obiliqit. Kryesuesi e arsyetoi se në muajin mars do ti marrim të dhënat e sakta edhe për qeverisjen Gashi dhe qeverisjen Krasniqi, që ta shohim gjendjen reale, por në fakt pa e ditë gjendjen reale të të punësuarve për ato parcel, që i kemi dhënë, unë do të jem kundër.

Ibush Mjekiqi – Së pari Kryetari nuk ka favorizuar askend, por në shqyrtimin e kërkesave të operatorëve ekonomik në pjesën e debatit keni marrë pjesë edhe ju. Kryetari i Komunës, nuk punëson punëtorë në KEK, por janë procedurat dhe ligji. Nëse, ligji nuk zbatohet në KEK, sa e di unë një pjesë në konkursin e fundit janë konsultue me ligjin dhe faktikisht kjo tregon se është zbatue një dispozitë e ligjit. Pra, jo vetëm ky Kryetar por cilido tjetër, që vjen nuk ka mundësi të punësimit në KEK.

Lulzim Sadiku – Unë e mora si shembull çështjen e KEK-ut, që ka qenë Ligji për Obiliqin, ka qenë e njëjtë me kontratë dhe dokumente qysh jam duke folë për operatorët ekonomik, se ne do ti kemi me shkollim të barabartë me përparësi punësimi. Kjo, nuk ka ndodhë dhe ka kalue Ligji për Obiliqin, e ceka se ky nen nuk përfillet, por për këtë është thirrë Kryetari i Obiliqit, njëkohësisht edhe për operatorin ekonomik, që ka ardhë operatori më serioz dhe vjen nga Drejtoria dhe Kryetari i Komunës. Kjo, do të thorrë se për operatorin për të cilin po flasim me ia dhënë pronën komunale, është i zgjedhur nga struktura dhe Kryetari i Komunës.

Ibush Mjekiqi – Sqaron se nuk është i zgjedhur, por është aplikues që ka bërë kërkesë dhe ne si qeverisje komunale dhe ju si Kuvend jemi të obliguar ti kthejmë përgjegje pozitive, ose negative. Këtu, nuk ka favorizime, janë 10 operatorë që kanë bërë kërkesa dhe 3 prej tyre konsiderojmë se i kanë plotësue kriteret mbi bazën e të cilave ne i kemi procedue në Kuvend.

Nazmi Gashi – Unë e di ku është kjo hapësirë e bizneseve sepse 20 vite, kam qenë kryeinspektor dhe aty njerëzit kanë tentue me ndërtue, me uzurpue pa ligj, pa sistem juridik vetëm me hy aty. Ne e kemi shpëtue atë hapësirë, është fat që e kemi dhe është fat që dikush po vjen, e po na lutë me bë investime. Aty, ka firmë që po investon 5 milion, ka firmë që po investon 3 milion dhe numri total i të punësuarve mund të shkoj prej 150-200 në tërësi. Unë i lus kolegët që këtë çështje ta marrin serioze, por duhet me ditë edhe çka me kërkue. Ne duhet me i dhënë pronat me mençuri, me interes të kapshëm që ia shehë hajrin edhe qytetari, administrata dhe Komuna.

Shaip Paloja – Unë kam qenë pjesë e takimit me operatorët për marrjen e tokave komunale në shfrytëzim dhe ligji ia mundëson Kryetarit për fillimin e një negocijimi për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale, por siç dihet vendimin e marrë Kuvendi komunal. Gjatë prezentimit të këtyre operatorëve, mua më vjen mirë që nuk kanë ardhë disa operatorë, që kanë pasë pretendime me marrë tokën, së paku gjatë prezentimit të tyre dhe të ia shtojnë ndotjen ambientit të Komunës tonë, si disa betonjerka e shumë të tjerë. Sa i përket propozim vendimit që e ka sjellë Kryetari, mendoj se ata ishin shumë serioz, bile unë pres që të ketë edhe në të ardhmen disa tjerë. Mua, më ka pëlqye sepse është kriter primar i një parku të biznesit, që të formohet që ai zinxhiri në mes të kompanive, që të gjitha mbetjet që ata i krijojnë njëra tjetrën duhet ti shfrytëzoj. Psh siq është përpunimi i letres, drurit etj. Tani, sa do ti përmbushin ata obligimet që do ti marrin do ta shohim në të ardhmen. Mendoj se duhet ta kemi parasysh se në Komunën tonë, po investohen miliona dhe obligimet e Komunës, besoj se do të jenë shumë të mira. Së paku, prezentimet e tyre kanë qenë kështu, dhe ne do të jemi non-stop në vëzhgim të tyre.

Hysni Mjeku - Unë besoj se të gjithë operatorët gjatë demonstrimit të kushteve të tyre kanë qenë jashtëzakonisht të mirë. Ne nuk kemi qenë aq profesionistë me i vlerësue, por mbi të gjitha në bazë të fotove që i jepnin ata, ishin operatorë të qëndrueshëm dhe faktikisht biznese të qëndrueshme. U potencua edhe një kompani për prodhimin e betonit, që sipas standardeve i plotësonte të gjitha kushtet pa marrë parasysh se kush është, do të thotë të gjithë operatorët para neve dhe Kryetarit sidomos zëdhënësit e tyre e kanë bërë demonstrimin jashtëzakonisht në mënyrë shumë profesionale. Prandaj, unë edhe në atë takim isha pro të gjitha bizneseve, megjithatë dikush duhet të përzgjedhet më i miri, që është edhe interesi i Komunës tonë. Ne e kemi marrë një vendim se do të jemi të hapur ndaj bizneseve, nuk duhet ti mbyllim dyert sepse fundi i fundit më mirë të shpenzohet ajo që kemi arritë se sa psh të kemi probleme edhe me uzurpatorë të tjerë.

Dragan Dancetovic – Çdo investim është i dobishëm për qytetarët e Komunës së Obiliqit, është prioritet për qytetarët e Obiliqit, punësimi dhe zhvillimi i ekonomisë. Ne përmes këtij procesi japim në shfrytëzim pronën komunale për 99 vite. Është shumë e rëndësishme përveç përmbushjes së shumë kritereve ligjore, atë që e propozojnë edhe obligohen investitorët duhet ta përmbushim. Një prej atyre kushteve është përmbushja e obligimit për punësimin e qytetarëve të Komunës së Obiliqit. Pasi që në Komunën tonë, jetojnë komunitete të ndryshme, një prej kushteve do të ishte edhe punësimi i komunitetit pakicë, normalisht duke e përmbushë kriterin e kualifikimeve dhe tek pastaj, nëse nuk kemi kuadro nga Komuna jonë të punësohen nga Komunitat tjera.

Kryesuesi – Edhe unë jam dakord me pjesën e procesimit dhe inkuadrimit si kriter punësimi.

Fatmir Bekteshi – Është e vërtetë se atë ditë kam qenë gjatë gjithë kohës prezentë dhe kanë qenë 10 ofertues. Ne jemi për çdo investitorë që vjen në Komunën tonë për atë pjesë, por ti përjashtojmë ata që ishin për betonjerë sepse atë ditë kanë qenë 3 për betonjerë. Unë dua që ne si Komunë të mos vonohemi me investimet tona që na takojnë neve, sidomos në infrastrukturë rrugore të kemi investime sa më shpejtë.

Kryesuesi – Mund të them se ndoshta, është njëra nga proceset më transparente për dhëniën e pronës në shfrytëzim. Unë sinqerisht e përgëzoj Ekzekutivin dhe Kryetarin e Komunës, për transparencën e treguar për ftesën që të gjithë anëtarët e Kuvendit komunal me qenë prezentë kur bëhet prezentimi i propozim projekteve. Kjo, na bën me qenë sa më të hapur në mënyrë që ne si Asamble komunale, me qenë të orientuar se nga po shkojmë.

Fatmir Bekteshi – Pothuajse, atë ditë shumica absolute kanë dhënë premtime se ka me pasë punësim nga Komuna jonë, por ne kemi pasë premtime edhe më heret që nuk i ka mbikqyrë askush. Tani, na mbetet neve

me formue një Komision, se edhe Kryetari iu tha gjatë prezentimit se ne qysh ua japim tokën mund edhe të ua marrim nëse, nuk i përmbahen premtimeve. Të paktën, ne duhet ti mbykqyrim psh njëri thotë do ti punësoj 50, atëherë 25 tonët duhet të jenë, do të thotë me i mbykqyrë.

Lulzim Sadiku – Unë fillimisht kur thashë se Kryetari i ka përzgjedhë, ti the se Kryetari i ka orientue, që përafërsisht i bjen e njëjtë sepse Kryetari që i ka përzgjedhë dhe i ka orientue, ne e dijmë se ai nuk voton. Pra, këtu kam të drejtë kur thashë se Kryetari i ka orientue operatorët ekonomik të cilëve ua dha tokën.

Muhamet Mustafa – Edhe unë nga kureshtja kam qenë prezentë tërë kohën aty, gjatë prezentimit të ofertuesve dhe më ka pëlqye shumë transparenca. Atë ditë i patëm 10 ofertues dhe në fund unë Kryetarit për oferuesit e betonjerkave, i propozova të mos jepet leja për ata për arsye se nëse, lejojmë të vjen edhe betonjerka aty, do të jetë problem se shkojnë me kamiona me gurë dhe neve mund të na ikin edhe këta ofertues.

Labinot Mirena – Kërkoj që ditën e premtë kryesuesi, në të ardhmen të mos thirrë seancën e Kuvendit komunal sepse asamleistët shkojnë në xhami.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe me 4 vota kundër e aprovuan Vendimin Përfundimtar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën në Kadastrale Llazarevë, Investitorit “Medruplast SH.P.K.”

Kryesuesi – Paraqet Propozim vendimin e Kryetarit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë Investitorit “Elita OP”.

Fatmir Bektashi – Unë kam qenë prezentë edhe te ky ofertues i cili ofroi 3 milion investim. Unë nuk e njohë atë person, por fjalë të mëdha dha mjaft dhe kërkoi që të ia fillon rrugës vetë, ta bëjë infrastrukturën deri te parcela e tij. Ai ishte i interesuar që menjëherë të ia filloj punës dhe tash, neve na mbetet me monitorue atë dhe nëse, nuk i përmbahet premtimeve ne duhet me ndëshkue atë.

Lulzim Sadiku – Këtu, po flitet për parcela, për dhënien e pronës komunale dhe nëse, nuk ka disponim bën me shtye edhe për seancën tjetër sepse atë tokë nuk e kemi shfrytëzue qe 20 vite. Këtu, u tha se investitori do të investoj 1 milion e 50,000 €, dhe do ti merrë 15 punëtorë. Unë dua të di për operatorin ekonomik që po flasim që ka dashur me shtrudh rrugën deri te parcela e vet, është mirë të bëhet një vlerësim i saktë që operatori i përzgjedhur nga Kryetari me stafin e tij neve, të na japë të dhënat e sakta për sa do të ndërtohet, për sa do të bëhet investimi, ku do të investohet dhe ku do të punësohen ata 15 punëtorë. Është mirë të jetë një kontratë që me na bind neve, se i merrë 15 punëtorë dhe me pasë në materialin tonë se ne i kemi punësue 15 punëtorë të Komunës së Obiliqit, që janë me gjendje ekonomike të dobët. Ai ka thenë se do ti punësoj 15 vetë, por unë besoj se do ti punësoj 16 sepse edhe një punëtorë e merrë plus, prandaj me të thëna nuk punohet dhe nuk jepet prona shtetërore. Mendoj se po manipulohet me pronat shtetërore dhe nuk duhet me ju dhënë njerëzve pronë që nuk jepin asnjë përgjegjësi. Vërtetë, kjo po ia humbë kuptimin anëtarit të Kuvendit komunal, të cilit i ka besue dikush dhe ia ka dhënë votën. Kjo është vërtetë për keqardhje dhe unë ashtu qysh po e shohë si po jepet prona shtetërore, po më orienton mos me ardhë në takim fare dhe kjo nuk është në rregullë.

Kryesuesi – Mua, më vjen keq që nuk e lexon materialin, e keni planin dinamik, e keni planin e investimeve, i keni hapësirat investuese me të gjitha dokumentet përcjellëse. Ju mund të bëni politikë, por është propozim i Kryetarit dhe ligji ia ka dhënë atë të drejtë. Ky është projekti më transparentë që ka mund me ndodhë për dhënien e pronës në shfrytëzim dhe kjo është pronë publike në përgjithësi e të gjithëve.

Lulzim Sadiku – Kryesues, ndoshta po të pengoj që po ti gjejë këto vërejtje dhe ti për çdo mbledhje e dëshmon se je për vërejtje sepse MAPL-ja, për çdo seancë e kthen nga një vendim që e merrë joligjor. Nëse, do të kishte Kryetar Komune dhe nëse, dikush është për vërejtje, atëherë ti nuk do të uleshe atje si kryesues sepse për çdo seancë e ke të kthyer nga një vendim nga MAPL-ja. Unë thashë përzgjedhjen që e ka bërë që ligji ia ka lejue në vitin 2019, 2020, e di konkretisht dhe e thashë se është e drejtë e tij me i zgjedhë operatorët ekonomik për të cilët mendon se janë operatorë më stabil, apo njerëz që mund të kontribuojnë për punësime sepse nuk jepet prona shtetërore vetëm ta ketë dikush në emër të tij. Mendoj se me këto ndarje që janë bërë në mandatin Gashi, mbi 50 %, e ke pronë të pashfrytëzueshme. Është mirë që kjo pikë të

shtyhet, të jetë edhe Kryetari prezentë dhe herave tjera, kur japim pronë komunale është mirë me ditë gjendjen reale

të tyre sepse ka mundësi që secili anëtar i Kuvendit, ta shohë gjendjen reale, e jo ta rregulloj rrugën, ta bëjë këtë e këtë sepse është pronë shtetërore.

Kryesuesi – Kryesuesi është njëri prej atyre që i nënshkruan vendimet e Kuvendit dhe uroj që MAPL-ja, të na monitoron rregullisht dhe vendimet e tilla të na i kthen, pse jo. E di politikën tënde dhe ti nuk më ke zgjedhë, por më kanë zgjedhë qytetarët dhe kolegët të cilët i falenderoj dhe unë mundohem me dhënë më të mirën të mundshme bashkarisht me juve. Mund të shkelet një pikë apo ndonjë aline, por vendime të kundërligjshme nuk marrim, por të gjitha i marrim brenda kompetencave tona ligjore.

Fatmir Bektashi – Është votues i yti, është i atij, edhe ky i ka disa votues dhe a votojmë apo nuk votojmë, është e drejtë e tij me votue, apo me mos me votue. Atë ditë, ky nuk ka qëndrue deri në fund sepse vetëm një ofertues e ka dëgjue dhe ka ikë. E vlerësoj, se ndoshta Medruplastin po, Elitën jo, shembull po e marrë, ne e vlerësojmë. Unë nuk e dëgjoj as z.Xhafer Gashin, as z.Lulzim Sadikun, as askend, por e vlerësoj vetë se a votoj apo nuk e votoj.

Lulzim Sadiku – Unë jam një njeri që asnjëherë nuk kam thënë voto pse unë e kam drejtë apo padrejtë nuk më intereson për askend qysh voton e vepron, as brenda Kuvendit, as jashtë Kuvendit, a shitet, apo blehet. Në mënyrë kolegiale, asnjëherë nuk e kam përmendë emrin dhe nuk kam kërkuar nga askush se a ka përfitue që ka votue apo nuk ka përfitue. Unë e japë mendimin tim si anëtar i Kuvendit komunal dhe e ndaj mendimin tim që e votoj. Është sistem i demokracisë dhe këtu jemi të thirrur për me bisedue për çështje madhore dhe e votojmë si të duash, por asnjë person nuk mund të më thotë se i kam thënë voto në këtë formë.

Hysni Mjeku – Vërtetë, ndoshta kisha diskutue më shumë sikur të mos kishte qenë takimi që është thirrë, por shumicën e bisedave i kemi krye atë ditë. Dua të ndalem te ky oferues i cili tha se mund të më kushton ndoshta 500,000 €, apo 700,000 €, një makinë, që brenda 2 muajve mund të dalë prej serisë. Mirëpo, mbi të gjitha edhe pse është një rrezik i tij, ai është përcaktue për 15 punëtorë që i pranon, por mjafton edhe 10 me i pranue sepse është interesi i Komunës. Mirëpo, është edhe interesi i tij se ai është në rrezik sepse prodhimi i drurit dhe teknika e drurit, dita ditës po ndryshon. Unë pajtoj me juve, se ne diskutojmë këtu për atë dhe jemi Kuvend, kundërthënjet janë shumë normale. Gjatë demonstrimit të projekteve, unë asnjë projekt nuk kam mund me largue, por në aspektin teknik e profesional unë nuk mund ta di. Prej të gjithë operatorëve, ata që janë përzgjedhë unë jam pro tyre sepse për mua asnjë nuk janë të disfalifikuar në aspektin e demonstrimit, por tash dikush duhet të fitoj.

Nazmi Gashi – Unë po mundohem me qenë më i thjeshtë dhe më i afërt për të gjithë. Ne kemi ardhë të bëjmë debat të mirëfilltë, debat që i kemi obligim votuesit, debat që i kemi interesat e qytetarëve dhe interesat tona të përbashkëta. Disa rregulla administrative janë që duhet ti respektojnë edhe ata që vijnë pas neve, do të thotë nuk i jepet askujt diçka falë sepse dikush e përcjellë. Ne duhet të krijojmë një sistem administrativ shtetëror, që mos me humbë besimi te njëri tjetri. Prandaj nëse, është interesi duhet me logjikue me gjakftohtësi dhe me i zgjidhë problemet në interesin e përgjithshëm.

Ibush Mjekiqi – Së pari, ishte mendimi juaj që mos të lexohet Propozim vendimi, e jo që nuk deshti kryesuesi. Këtu, u përdorë një fjali manipulim, por Kryetari i Komunës, e them me përgjegjësi të plotë se është duke i kryer obligimet ligjore për të cilat është i zgjedhur. Unë konsideroj se Kryetari i ka sjellë propozim projektet në bazë të veprimeve, që i ka ndërmarrë dhe në kuadër të saj ishte edhe prezentimi i kompanive para grupeve, apo anëtarëve të ftuar në atë takim.

Lulzim Sadiku – Unë e shprehu shqetësimin e njejtë se manipulimet janë bërë sepse fshati Mazgit ka ardhë me kërkesa, disketa dhe ka ardhë me probleme të ndryshme. Unë po e dëshmoj se atje qytetarët kanë ardhë për shumë probleme për parcelën për të cilën po flasim dhe kanë bërë ankesa me shkrim, iu kanë drejtue Kuvendit në forma të ndryshme. Mendoj se derisa atje, ka pakënaqësi të qytetarëve, gjithmonë ka manipulim.

Ibush Mjekiqi – Ti, vazhdon të mendosh se nuk është ashtu, por absolutisht manipulime nuk ka.

Hysni Mjeku – Në takimin që e kemi mbajtur për çdo operatorë Kryetari, decidivisht iu ka thënë se unë nuk garantoj se do të përzgjedhesh ti, kjo do të thotë se çështja është në dorë të asambleistëve dhe ata vendosin. Prandaj, ne jemi këtu që mundësisht më të mirin me zgjedhë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 3 vota kundër e aprovuan Vendimin Përfundimtar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme të Komunës, së Obiliqit në Zonë Kadastrale Llazarevë, Investitorit “Elita OP”.

Kryesuesi – Paraqet Propozim vendimin e Kryetarit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë Investitorit “Baruti Gorup SH.P.K”.

Enver Gashi – Ne këtu, jemi të thirrur ti mbrojmë interesat e qytetarëve të Komunës së Obiliqit dhe jemi të thirrur secili anëtar i Kuvendit, që kemi pasë gjatë fushatave kontaktet me elektorat, jemi të thirrur në sektorë që jemi mundue të rritet numri i të punësuarve Unë po shohë sot, ka plot demokraci që është e lejuar me votue, por jo me qenë kundër kësaj parcele që është në Llazarevë, që vërtetë iu ka kthye epiteti asaj dhe iu ka rritë vlera. Transparenca, ka qenë shumë e madhe ku janë ftuar të gjithë anëtarët e Kuvendit, drejtorët dhe Ekzekutivi, që e kanë paraqitur planin e tyre dhe ne si Kuvend aty kemi pasë të drejtë me kërkue sqarime, e jo me dhënë njëherë parcelën dhe pas 2,3 vjete, me mbetë djerrinë. Ndërsa, sa i përket dhënjes së parcelës dhe ai me punue menjëherë ne duhet me mirëpritë dhe me duartrokitje sepse një vend pune sot me hap është patriotizëm. Prandaj, ne si grup parlamentar i AAK-së, jemi dhe do ti përkrahim gjithmonë investitorët me mundësitë tona që i kemi.

Lulzim Sadiku – Unë vërtetë isha kritik kërkova sqarime, kërkova vendime, sigurime në fakt që mos të ndahen operatorët ekonomik. Ndërsa, për pikën e 3, do të kursehem pak sepse vërtetë është i përzgjedhur operatori ekonomik i domosdoshëm, nuk po dallon shumë a e ka një presje dhjetore, a është 900,000 apo 9 milion, vërtetë është pak, kështu që s’kam çka të them më shumë. Mund të flasim ose 900,000 ose 9 milion dhe nuk e dijmë se a e ka presjen apo nuk e ka, kështu që s’kam çka të jepi as kritikë, as mendim, as veprim për të. Shkruan 900,000 €, dhe nuk e dijmë a është 900,000 €, apo 9 milion, por me rëndësi është se po e japim pronën dhe shifrat nuk janë me rëndësi a janë 900,000 apo 9 milion. Unë kur po kritikoj dikujt po i duket se kam qëllime. Të gjithë jemi të thirrur të bëjmë zgjidhje për qytetarët, por përzgjedhja nuk bëhet kur nuk e dijmë shifrën a është 900,000 €, apo 9 milion. Unë nuk besoj se mundet dikush me më bind me votue sepse dallon 8 milion e 100,000 €, që ndoshta për dikend janë pak, por për dikend janë shumë.

Kryesuesi – Unë e pashë se është gabim teknik. Në dokumentin që ju e keni pranue zyrtarisht në planin zhvillimor të biznesit të tij është 900,000 €, por me shifrat tona është 9,000 €. Investimi është 900,000 €, dhe propozimi që ka ardhë këtu 9,000 €, është gabim teknik.

Muhamet Mustafa – Gjatë prezentimit secili ofertues që është ulë në karrigë me prezentue ofertën e vet i pari e ka marrë fjalën Kryetari i Komunës dhe secilit ofertues ditën e parë ia ka shpjegue se këtu janë prezentë anëtarët e Kuvendit, Ekzekutivi dhe kryesuesi i Kuvendit komunal, se këta e marrin vendimin për dhënien ose mosdhënien e pronës. Po ashtu, iu ka thënë se e kanë të drejtën nëse, operatori ekonomik nuk e përmbushë ofertën që e bën para asambleistëve gëzon të drejtën që formohet 1 Komision, vlerësohet se a e ka plotësuar ofertën, apo jo dhe e gëzon të drejtën që ti merret prona. Kjo, ka qenë fjala e parë e Kryetarit për secilin operatorë.

Nazmi Gashi – Kjo më ka pëlqye më së shumti sepse vetëm këtë vit 30 copë ftonj, më kanë shkue poshtë, kështu që uroj të bëjmë diçka të mirë në këtë drejtim.

Fatmir Bekteshi – Atë ditë tha se i punësoj 120 vetë, por 70 % prej tyre kanë me qenë.

Lulzim Sadiku – Këto, të thëna na kanë lënë këtu ku jemi sepse edhe ish Kryeminsitri ka thënë se do ti punësoj banorët e Hades dhe Shipitullës, por nuk i ka punësue. Prandaj, është mirë që gjërat të shkruhen dhe të merren vendimet e drejta.

Ibush Mjekiqi – Sqaron se nuk është me të thëna, por ky është vendim i shkruar që merret për dhënien e tokës në shfrytëzim. Të gjitha çështjet precizohen në kontratën të cilën e nënshkruan Kryetari me operatorin ekonomik dhe Shipitulla e Hadja, janë punësue krejtë, mos e ke brengën.

Lulzim Sadiku – Më vjen mirë nëse, janë punësue Hadja dhe Shipitulla, i përgëzoj nëse janë punësuar, por nuk është e vërtetë.

Fatmir Bektashi – Unë kam një kërkesë që të paktën ne të kemi qasje në parcelat të cilat jepen në shfrytëzim, në seancën e radhës të dijmë se për cilën parcelë po bëhet fjalë, pastaj ti shohim hapat tjerë.

Ibush Mjekiqi – Sqaron se i ke në web faqe të Komunës, në DPUKP se cilat prona janë të lira është thirrja publike, që i sjellë këta operatorë me konkurre.

Labinot Mirena – E falenderoj z.Lulzim Sadiku, për kujdesin ndaj banorëve të fshatit Hade, por është pikërisht ky dhe partia e tij që kanë punuar kundër punësimit të Hades.

Lulzim Sadiku – Unë ty nuk ta përmendi emrin se e di sa vlen në Kuvend, dhe ti je përfaqësues i qytetarëve të Obiliqit, ndërsa unë jam përfaqësues i zgjedhur i qytetarëve. Unë ty asnjëherë nuk ta kam përmendë emrin dhe të kisha lutë që mos ma përmendë emrin.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 4 vota kundër e aprovuan Vendimin Përfundimtar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme të Komunës, së Obiliqit në Zonë Kadastrale Llazarevë, Investitorit “Baruti Group SH.P.K”.

Pika e 7 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën për vazhdimin e financimit të projektit për mësimin joformal, që organizohet në SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova”.

Agim Spahiu – Ju njoftoj se këta 15 vijues janë nga klasa e 7 - 9, e propozoj dhe e mbështesë kërkesën e drejtoreshës që të vazhdohet financimi i arsimit joformal në SHF deri me 30 maj 2021.

Lulzim Sadiku – Kjo kërkesë është e domosdoshme dhe jam pro kërkesës sepse shumë gjenerata nuk kanë mund me krye më heret për arsye të okupimit të asaj kohe dhe për arsye të nacionaliteteve të ndryshme.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për e aprovuan Vendimin për vazhdimin e financimit të projektit për mësimin joformal që organizohet në SHFKU “Dr.Ibrahim Rugova” që nga janari i vitit 2016.

Kryesuesi – Paraqet kërkesën nga MAPL-ja, për rishqyrtimin e vendimit të Kuvendit komunal nr.I-227, të dt.27.12.2019.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për e aprovuan Vendimin për rishikimin e vendimit nr.I-227, të dt.27.12.2019, për ndarjen e mjeteve buxhetore për transportin e 22 nxënësve në relacionin Mazgjit-Shkabaj dhe anasjelltas.

Kryesuesi – Paraqet kërkesën e DKRS-së, për formimin e Komisionit për hartimin e Statutit të Ansambllit të Qytetit.

Enver Gashi – Propozon znj.Arbnore Nasufi, anëtare të Komisionit.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për e aprovuan Vendimin për themelimin e Komisionit për hartimin e Statutit të Ansambllit të Qytetit me këtë përbërje:

1. Rifadije Paloja, DKRS, Kryetare e Komisionit

2. Bislim Bislimi, MKRS, anëtar

3. Besnik Grajqevci, Ansambli i Qytetit, anëtar

4. Ramadan Qunaku, Teatri i Qytetit, anëtar

5. Arbnora Nasufi, anëtare e Kuvendit Komunal, anëtare

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit lidhur me Njoftimin e pranuar nga drejtoresha e DSHMS-së, për koronavirusin dhe hapat që duhet ndërmarrë në këtë drejtim.

Ibush Mjekiqi – DSHMS-ja, është e përgatitur për këtë situatë dhe mesazhi i Drejtorisë është se nuk ka nevojë për panikë sepse ne jemi të përgatitur me të gjitha pajisjet e nevojshme dhe jemi në menaxhim të situatës. Po ashtu, është ekipi ynë i cili duhet të kujdestarohet në aeroportin “Adem Jashari” me të gjitha mjetet e nevojshme. Ju njoftoj se Kryetari ka marrë vendim bashkë me drejtorët që këtë vit të subvencionoj me nga 150 €, çdo lindje në Komunën tonë prej janarit të këtij viti. Numri i lindjeve brenda vitit në Komunën e Obiliqit është prej 250-300 dhe do të përcaktohen kriteret e përfituesve, por si kriter i parë është të jetë banor i Komunës së Obiliqit, statusi martesor etj.

Hysni Mjeku – Këtu, u tha se si kriter ishte të jetë banor i Obiliqit, që është gabim i madh antiligjor sepse nëse, pacientja vjen nga Vushtrria dhe don të shkon në Prishtinë, por lind në Obiliq, atëherë ajo llogaritet si banore e Komunës tonë. Prandaj, nuk është mirë ashtu të precizohet. Unë kam dëgjuar se në Komunitet tjera marrin më shumë deri në 250 €.

Ibush Mjekiqi – Sqaron se masa buxhetore aq ka qenë për këtë çështje.

Kryesuesi – Paraqet shkresën lidhur me gurëthyesin në Sibofc, drejtuar MMPH-së, Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural dhe Komisionit për Minjera dhe Minerale.

Ibush Mjekiqi – Ne shkresën ia kemi dërguar Ministrive të linjave, por me rëndësi është se asnjë aktivitet ajo kompani nuk e kryen aty, derisa të sqarohen këto çështje në detale.

Fatmir Bekteshi – Unë kam kërkuar edhe në mbledhjen e KPF-së, pse ne nuk po pajisemi me dokumentacion të Komunës, që iu ka lëshue atij. Ne e dijme se shkresën ia keni dërgue Ministrive, por dokumentet e Komunës së paku ne duhet ti kemi.

Kryesuesi – Unë nuk e di se dikujt iu ka dhënë pëlqim me punue. Në mbledhjen e radhës çdo dokument lidhur me këtë çështje do të ju dërgohet edhe juve. Është me rëndësi se punimet ju kanë ndërprerë dhe presim përgjegje nga Ministria për këtë çështje.

Lulzim Sadiku – Edhe unë kisha dashur me pa dokumentacionin në kuadër të Rregulloreve, që flasin besoj se edhe nëse, iu ka dhënë pëlqimi është bërë gabim. Kjo nga fakti se në kuadër të Rregulloreve, për gurëthyes dihet se sa duhet të jetë afërsia, nuk do ti jepet leje ndërtimi nga Kuvendi komunal nga se ata janë pjesë e jona. Mendoj se duhet të gjejmë një gjuhë të përbashkët, që mos të ju japim leje ndërtimi që me shkatërrue atë pikë atje, për të cilën po flasim. Unë pajtohem se puna është ndërprerë dhe është dashur që ajo punë të mos vazhdoj më, por drejtori përkatës i ka dhënë një pëlqim atij derisa ka shkue në kuadër të Ministrisë. Unë kam marrë informata në Sibofc, se në kuadër të inspektoriatit të Ministrisë për Minjera dhe Minerale, është një lëndë e tij kinse ka mbajtur takim me qytetarë në Mazgit. Prandaj, ne presim që të na vjen krejtë materiali dhe të mos i jepet mundësia që ai atje të punoj.

Kryesuesi – Sqaron se unë sa e di për gurëthyes nuk ka leje të ndërtimit nga Komuna e Obiliqit.

Ibush Mjekiqi – Kam informata, por nuk dua ti shpaloj derisa të kompletohet lënda dhe nëse është e nevojshme ne javën tjetër, mund ta thërrasim një seancë të jashtëzakonshme dhe të debatojmë për këtë çështje.

Pika e 8 e rendit të ditës

Lulzim Sadiku - Unë disa herë e kam potencue çështjen e administratës së Kuvendit dhe kërkoj që vërtetë ta kemi një administratë efikase, me pasë një nga zyrtarët ligjor që mos të na kthehen më këto vendime. Po ashtu, kërkoj që të merren ekspertë të cilët e kryejnë këtë punë dhe të mos na kthehen vendimet prapa.

Mbledhja përfundoi në ora 13:43'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli



Kryesuesi i Kuvendit komunal


Burim Gërguri